



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:075030

Datë: 11.02.2020

Numri i dokumentit: 00826024

P.nr.183/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari me procesmbajtësen Erjona Bytyqi praktikante e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. Z., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 parg.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm PP.II nr.50-11/2019 të dt. 21.05.2019, në shqyrtimin fillestar të mbajtur datë 11.02.2020, në prani të Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro, dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit sipas autorizimit av. N. B. nga Suhareka, mori dhe publikishtë shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Xh. Z. nga i ati M. dhe e ëma A. e lindur G., i lindur me 08.05.1980 në fshatin B. komuna e Suharekë, ku edhe jeton, me numër personal, i martuar, ka të kryer shkollimin fillor, me vendqëndrim të përhohshëm në Austri, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar,

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datë 04.01.2019 rreth orës 17:40, në fshatin B. komuna Suharekë ne shtëpinë e tij familjare, gjatë një kontrolli të kryer nga policia mban ne pronësi armë të zjarrit, pa leje te organit kompetent dhe në kundërshtim me ligjin nr. 05/L-022 per armët, dhe atë: 1 (një) pushkë automatike AK 47 te kalibrit 7.62 mm, prodhimi Z. – K., J., model M..B./1983, me numer serik :..... dhe (1) karikator i zburur i të njëjtës armë, të cilat gjatë kontrollës nga ana e policisë arma dhe karikatorit i janë sekuestruar.

-me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 parag.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082

Gjykata në kuptim të neneve 4.7,17,21,41,43,46, 69 parag.1,73,74, 374 parag 1 dhe 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082, nenit 365, dhe 450, të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK) 04/L-123 të akuzuarin:

E G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej **600 € (gjashtë qind euro)**, të cilin duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata do t'ia të zavendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke i'a shëndrruar dënimin me gjobë në 30 (tridhjetë) ditë dënim me burg, ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 € (njëzet) Euro gjobë,

Obligohet t'i paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, dhe në emër të taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumë prej **30 € (tridhjetë euro)**, të gjitha këto pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet **DËNIM PLOTESUES**, ashtu që i konfiskohet 1(një) pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7.62 mm, prodhimi Z. – K., J., model M..B./1983, me numer serik :..... dhe (1) një karikator i zbratur i të njëjtës armë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II nr.50-11/2019 të dt. 21.05.2019 e ka akuzuar Xh. Z., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 parag.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), aktakuzë të cilën e ka përfaqëuar prokurori i shtetit Atnor Skoro.

Në shqyrtimin fillestar mbajtur me datën 11.02.2019, është lexuar aktakuza nga Prokurori i Shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale me të cilën akuzohet duke deklaruar se pranoj fajsinë për veprën penale që akuzohem.

Mbrojtësi i të pandehurit Av.N. B. lidhur me deklarin e të mbrojturit të tij është pajtuar në tërësi lidhur me deklarin mbi pranimin e fajsisë të cilin deklarim e ka bërë edhe në prokurorinë e shtetit gjatë dhënies së deklaratës së tij ku i njejt ka pranuar se këtë armë e ka pas si trofe të luftës së fundit në Kosovë dhe të njejtën ka pasur për qëllim të legalizoj pasiqë atë armë asnjëherë nuk e ka përdorur për gjuajtje ose qëllime tjera. Mbrojtësi i të pandehurit poashtu ka kërkuar nga gjykata që për të pandehurin të shqiptohet një dënim me gjobë sa më i butë për faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me gjykatën, ka qenë korrekt dhe me sjellje të mira gjatë dorëzimit të armës, dhe se nuk është në gjendje të mirë shëndetësore.

Prokurori i Shtetit lidhur me deklarimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë, ka theksuar se nuk e kundërshton deklarimin e të akuzuarit për ta pranuar fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë, pas konsultimit të pandehurit edhe me mbrojtësin e tij, pranimi i fajsisë është bërë pas sqarimit të natyrës pasojave dhe favoreve të pranimit të fajit, dhe pranimi i fajsisë bëhet pa presion dhe faktet dhe provat që përmban akuza ndërsa pranimin e fajsisë të merret si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari vetëm gjykues pas deklarimit të të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit rreth pranimit të fajsisë ka marrë aktvendim me anë të cilit ka pranuar deklarimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë konform nenit 248 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082. Pastaj gjyqtari ka vlerësuar se i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajsisë është bërë në keshillim me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në deklarimin e të akuzuarit për ta pranuar fajsinë në tërsi për të gjitha pikat e aktakuzës, gjykata nuk administroi me provat në këtë çështje penale juridike, pasi që gjykata ka konstatuar dhe vërtetuar të tërësi këtë gjendje të pakontestueshme faktike:

Me datë 04.01.2019 rreth orës 17:40, në fshatin B. komuna Suharekë ne shtëpinë e tij familjare, gjatë një kontrolli të kryer nga policia mban ne pronësi armë të zjarrit, pa leje te organit kompetent dhe në kundërshtim me ligjin nr. 05/L-022 per armët, dhe atë: 1 (një) pushkë automatike AK 47 te kalibrit 7.62 mm, prodhimi Z. – K., J., model M.B./1983, me numer serik :..... dhe (1) karikator i zburur i të njëjtës armë, të cilat gjatë kontrollës nga ana e policisë arma dhe karikatorit i janë sekuestruar.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit si dhe nga provat e pa kontestueshme dhe faktet që i përmban aktakuza, siç janë; procesverbalin mbi marrjen ne pyetje te te pandehurit ne proceduren paraprake te dt.10.05.2019, deklarates se te pandehurit Xh. Z. e dhënë në polici me nr. rastit 2019-GB-... të dt.04.01.2019, deklarates së dëshmitarit Q. Z. e dhënë në polici me nr. rastit 2019-GB-... të dt.04.02.2019, lista e armëve te konfiskuara me nr. të rastit 2019-GB-... të dt.04.01.2019, si dhe fotodokumentacioni ne shkresat tjera të lëndës.

Nga këto fakte dhe prova të konstatuara dhe vërtetuara në procedurë nga veprimet e të akuzuarit dhe nga vetë pranimi i fajsisë së të akuzuarit, përmbushën të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me dashje dhe duke e mbajtur dhe poseduar armën në mënyrë paautorizuar dhe të kundërligjshme sipas ligjit të aplikueshëm mbi armët 05/L-022 me të cilën realizohen tiparet e përgjithshme dhe të veçanta të kësaj vepre penale për të cilën është gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73,74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin muar faktin se e ka pranuar fajsinë, se ndihet i penduar dhe i ka premtuar gjykates se nuk do të përsërisë asnjëherë këtë vepër penale, se është mbajtës i familjës dhe i gjendjes së dobët ekonomike, i gjendjes se rëndë shëndetësore dhe në terapi të vazhdueshme, dhe është rast social.

Për këtë veprë penale është paraparë dënimi me gjobë deri 7500 euro ose dënim burg deri në 5 vite, të njëjtit i'u shqiptua dënimin me gjobë prej 600 € (gjashtë qind euro), me bindjen se ky dënim është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në nenin 450 parag. 3 të të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK) 04/L-123, ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjëndjen financiare të akuzuarit, ndërsa shumën prej 30 euro në emër të viktimave të krimit bazuar në nenin 39 parag.3 të Ligjit mbi Kompenzimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimin që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi plotësues në lidhur me konfiskimin e armës gjykata e bazoi në nenin 69 para.1 dhe nenit 374 paragrafi 3 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal
P nr. 183/19, datë 11.02.2020

Procesmbajtësja
Erjona Bytyqi

G j y q t a r i
Lavdim Bajraktari

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.